



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 59

Prishtinë, më 02.10.2012, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 27.08.2012;
3. Shqyrtimi i Raporteve nga Ministria e Punëve të Brendshme
4. Formimi i grupit punues për hartimin e Projektligjit për Komisionerin për Siguri;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 27.08.2012

Kryetari i Komisionit- Konstatoi miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 27.08.2012, i cili u miratua pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Raporteve nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Kryetari i Komisionit- Për raportet e ofruara nga Ministria e Punëve të Brendshme, për përmbushjen e kriterëve të Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian dhe rekomandimet e dërguara nga ana e Komisionit për njoftimin nga ana e tyre rreth inventarizimit dhe kujdesin për dhomat e dëshmitarëve në nivel të rajoneve, tha se në raportin për përmbushjen e kriterëve për Integritet Evropian e vlerëson si përmbajtësor dhe përshkruar, ndërsa nëse ka vërejtje për raportin e ofruar dhe përmbajtjen e tij, hapi diskutimin për këtë çështje dhe ftoi anëtarët e Komisionit për kontributin e tyre.

Fatmir Xhelili- Për raportin e ofruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, që ka të bëjë me regjistrimin e provave dhe evidentimin e provave në dhomat e dëshmitarëve, tha se nuk është i kënaqur, pasi vlerësoi se do të ishte e nevojshme të bëhet numërimi se në të cilat dhoma është bërë inventarizimi, apo është bërë vetëm regjistrimi i tyre, procese që ndryshojnë mes tyre, gjithashtu theksoi se nëse bëhet inventarizimi, të dhënat futen në bazën e të dhënave në mënyrë që në to të kenë qasje personat e autorizuar. Tutje tha se, në raport nuk përfshihet nëse ka pasur dallime mes të dhënave që i ka dërguar Prokuroria, prandaj vlerësoi se përshkrimi me një fjali në raport se” *nuk ka pasur dallime*” nuk është e mjaftueshme për Komisionin, prandaj konsideroi se raporti nuk është i plotësuar dhe serioz.

Ndërsa për raportin e përmbushjes së kriterëve për Integritet Evropian, ai tha se është një raport informues, ndërsa për strategjitë e hartuara në të kaluarën dhe në vazhdimësi, në planin e veprimit, zërthehen një numër i madh i aktiviteteve në drejtim të parandalimit, ndjekjes dhe mbrojtjes së dëshmitarëve, viktimave dhe parashihen një numër i aktiviteteve të cilat kanë treguesit e caktuar, ku në bazë të tyre mund të arrihet në rezultate për të parë realizimin e veprimeve të planifikuara për afatet kohore të përcaktuara nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Gjithashtu ai tha se në këtë drejtim ka rezultate pozitive dhe se ngecja mund të jetë në drejtimin e ngritjes së standardit dhe cilësisë të zyrtarëve policor dhe strukturës për arritjen e standardeve të përcaktuara për integritetin evropian, ndërsa për mbrojtjen e dëshmitarit ai tha se krahas Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarit dhe njësisë që merret me këtë çështje, ka ngecje në këtë shërbim, pasi është dashur që një numër i zyrtarëve policor të trajnohen për këtë çështje, në mënyrë që pas përfundimit të misionit të EULEX-it, njësia për mbrojtjen e dëshmitarit t'i kalohet vendorëve. Në vazhdim shtoi se e

rëndësishme është hyrja në programin e mbrojtjes së dëshmitarit me shtetet evropiane dhe shtetet e tjera, në mënyrë që të arrihet mbrojtja e dëshmitarit.

Kryetari i Komisionit- Referuar raporteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ai tha se janë korrekte në aspektin e përshkrimit, ndërsa për vërtetësinë e gjendjes faktike e cila paraqitet në raporte dhe në përputhje me ligjet ekzistuese, janë për tu diskutuar nga anëtarët e Komisionit.

Rexhep Selimi- Për raportet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ai tha se i vlerëson si përshkruese dhe i mbështet vërejtjet e paraqitura nga z. Fatmir Xhelili.

Kryetari i Komisionit- Për raportin rreth procesit të regjistrimit dhe inventarizimit në dhomat e dëshmive, ai tha se gjithashtu pajtohet me vërejtjet e z. Xhelili, pasi është dashur një përshkrim më i drejtpërdrejtë dhe jo i përgjithësuar. Për këtë qëllim ai propozoi realizimin e një vizite nga ana e Komisionit në Drejtorinë e Policisë së Kosovës dhe vizitë në Akademinë Policore të Kosovës, në mënyrë që të shihet struktura dhe zhvillimet reale në këto institucione.

Rexhep Selimi- Për kërkesën e Komisionit e cila i është drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, për inventarizimin në dhomat e dëshmive, kërkesë e cila është mbështetur në mënyrë unanime nga anëtarët e Komisionit, ai tha se nga një raport i tillë është pritur më shumë punë. Tutje ai tha se kërkesa për një raport të tillë ka ardhur si rezultat i dy skandaleve që kanë ndodhur në dhomën e dëshmive në Prishtinë dhe në Pejë, gjithashtu ai konsideroi se kjo çështje nuk do të mbyllet vetëm me inventarizimin në dhomat e dëshmive, pasi sipas tij Komisioni duhet të bëjë presion në interes të përgjithshëm dhe mbrojtjes së imazhit të policisë.

Vjollca Krasniqi- Për raportet e paraqitura nga Ministria e Punëve të Brendshme, ajo tha se ka ngritje të efikasitetit të Departamentit për Luftimin e Trafikimit me Narkotik, gjithashtu në bazë të tabelave të sjella nga Policia e Kosovës është bërë një krahasim mes vitesh, muajsh dhe krahasime mes nacionaliteteve dhe përkatësisë gjinore. Tutje ajo vlerësoi se edhe pse ka një përparim në këtë fushë, nga Departamenti i Shtetit Amerika, Kosova mbetet një vend transit i narkotikëve, gjithashtu është shënuar një rritje e numrit të përdoruesve të narkotikëve nga ana e qytetarëve të Kosovës, prandaj konsideroi se Policisë së Kosovës, institucion i cili ka mandat të merret me këtë çështje, i mbetet shumë për tu bërë për zvogëlimin e një dukurie të tillë.

Ndërsa për dhomat e dëshmive dhe raportin e paraqitur për to, ajo tha se tani më asnjëherë nuk është në rend të ditës rasti i vjedhjes në dhomën e dëshmive në Prishtinë, duke u marrë vetëm me rastin e vjedhjes në dhomën e dëshmisë në Pejë. Prandaj konsideroi se nga ana e Komisionit duhet të kërkohej me vendosmëri për të parë procedurat e ndërmarra me këtë çështje, gjithashtu e konsideroi të rëndësishëm takimin e propozuar me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë.

Kryetari i Komisionit- Për realizimin e vizitës në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, ai tha se kjo do të bëhet në konsultimin me agjendën e tyre dhe se për datën do të

vendosët në pikën të ndryshme dhe me këtë e konsideroi të mbyllur këtë pikë të rendit të ditës.

4. Formimi i grupit punues për hartimin e Projektligjit për Komisionerin për Siguri.

Kryetari i Komisionit- Për këtë çështje, ai tha se është realizuar një angazhim i mëhershëm për hartimin e projektligjit për Komisionerin për Siguri, ku është konsideruar se në këtë kuadër duhet të hyjë, përveç FSK-së edhe Policia e Kosovës. Tutje ai njoftoi se është formuar grupi punues, ndërsa në takimin e sotëm do të bëhet zyrtarizmi i tij. Përbërja e këtij grupi punues është, z. Rexhep Selimi, Kryesues, Anton Quni, Fatmir Xhelili, anëtar, gjithashtu përmendi organizata që e mbështesin këtë projekt, siç është GIZ-i gjerman, DCAF-i. Gjithashtu njoftoi për takimin e realizuar me ish- Komisionerin e Mbrojtjes të Gjermanisë, z. Reinhold Robbe, me të cilin është rënë dakord vazhdimi i punës për hartimin e projekt ligjit në fjalë.

Për mundësin e realizmit të këtij projekti, ai tha se komunikimet do të vazhdojnë me Ministrinë e Financave, Komisionin për Buxhet dhe Financa në Kuvendin e Kosovës, dhe akterët e tjerë që mund të lidhën me këtë institucion.

Rexhep Selimi- Për themelimin e grupit punues i cili do të punoj për projektligjin për Komisionerin, ai vlerësoi se është e nevojshme votimi i anëtarëve të propozuar në Komision. Tutje ai tha se hartimi i këtij projektligji bëhet nga ana e Komisionit, si iniciues i këtij ligji dhe se procedurat do të jenë më ndryshe në këtë rast.

Në vazhdim ai njoftoi, se përbërja e grupit punues që do të punoj për projektligjin për Komisionerin ka një përbërje të gjerë dhe për këtë gjë është bërë kërkesë që në të, të përfshihen përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Ministria e FSK-së dhe FSK-ja. Prandaj ai konsideroi se grupi punues që do të merret me këtë çështje duhet të marrë miratimin e Komisionit dhe e konsideroi si të nevojshme rritjen e numrit të anëtarëve të këtij grupi nga radhët e Komisionit.

Kryetari i Komisionit- Për përbërjen e grupit punues që do të merret me projektligjin për Komisionerin për Siguri, tha se e përkrah propozimin z. Rexhep Selimi që kushdo që e konsideron të arsyeshme përfshirjen në këtë grup nga ana e anëtarëve të Komisionit, mund ti bashkohet atij, dhe ftoi anëtarët e tjerë që të bëhen pjesë e këtij grupi. Duke qenë se nuk patë anëtarë të tjerë të interesuar, hodhi në votim përbërjen e grupit punues që do të punoj për projektligjin për Komisionerin për Siguri.

Në këtë pikë të rendit të ditës Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime morri këtë:

VENDIM

Formohet Grupi Punues për Projektligjin për Komisionerin për Siguri, me këtë Përbërje, z. Rexhep Selimi, Kryesues, ndërsa Anton Quni dhe Fatmir Xhelili, anëtar.

5. Të ndryshme.

Kryetari i Komisionit- Në këtë pikë njoftoi për takimin e realizuar me përfaqësues të **GAP-it**, organizate e cila mund të mbështes Komisionin në sferën e sigurisë, ndërsa për datën e vizitës së Komisionit në Drejtorinë e Policisë së Kosovës dhe në Akademinë e Sigurisë Publike, propozoi që të realizohet të martën, 9 tetor, 2012. Për propozimin e dhënë kërkoi aprovimin e anëtarëve të Komisionit, për të cilën gjë anëtarët e Komisionit janë dakord të realizohet në këtë datë

Rexhep Selimi- Për vizitën që planifikohet të realizohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe Akademinë e Sigurisë Publike, ai tha se është e rëndësishme të dihet materia e vizitës dhe se sipas tij gjatë kësaj vizite duhet të përmendet edhe çështja e dhomave të dëshmimeve, ndërsa në Akademinë e Sigurisë Publike, qëllimi i vizitës do të duhej të fokusohet në zbatueshmërinë e ligjit nga ana e këtij institucioni.

Tutje ai shtoi se, grupi punues për mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së Ligjit të IPK-së, duke qenë se është në pjesën finale, propozoi që si pjesë e këtij takimi, gjatë vizitës në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë grupi punues të paraqes pyetjet që mund të ketë lidhur me zbatueshmërinë e Ligjit të IPK-së.

Kryetari i Komisionit- Për propozimin e dhënë nga z. Rexhep Selimi, ai tha se mund të jetë pjesë e agjendës gjatë vizitës në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

Goran Marinković- Në këtë pikë të rendit të ditës, ai ngriti çështjen e imazhit të Policisë së Kosovës, temë e cila do të duhej të ishte në takimet që do të realizohen me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës. Tutje ai propozoi që në takimin me të, të pyetet për rënien e besimit tek policia, si rezultat i veprimeve të disa individëve të caktuar, me arsyetimin se vepron sipas urdhrave. Gjithashtu ai propozoi që krahas takimit me Drejtorin e Përgjithshëm dhe vizitës në Akademinë e Sigurisë Publike, një takim i tillë të bëhet edhe me përfaqësuesit e IPK-së, për të ditur shkakun e disa ngjarjeve.

Tutje ai tha se nga takimet e kaluara në Komision, ai ka ngritur shqetësimin për ngjarjet në vendkalimin kufitar në Merdare, për të cilën gjë ka sjell fakte. Në vazhdim ai përmendi rastin e një qytetari nga radhët e komunitetit serb, i cili pasi e ka paraqitur patentë shoferin për ndryshim dhe me vete ka poseduar dokumentacionin që e dëshmon një gjë të tillë, ndërkohë personi është detyruar të paraqitet në gjykatë nga ana e zyrtarit policor. Gjithashtu ai tha se këtë e konsideron si rrënim të besimit të institucionit.

Në vazhdim të këtij diskutimi, ai tha se për çfarë arsye që për dokumentin e lëshuar nga MPB-ja, personi duhet të paraqitet në Gjykatë, për të cilën gjë ai ka sjell dokumentet si dëshmi e një veprimi të tillë. Gjithashtu ai shtoi se qytetari serb është ankuar tek ai, dhe se sipas tij nuk duhet të kapërcehen lehtë këto gjëra. Ndërsa, sa i përket informacionit të qytetarëve për tu drejtuar organeve kompetente, nuk e dinë nëse janë të vetëdijshëm për këtë gjë, ndërsa u ka sugjeruar që të ankohen dhe iu është sugjeruar nga ana e tij që të paraqiten në Stacionin Policor në Graçanicë dhe se nuk guxohet të dëmtohet autoriteti i policisë në këtë mënyrë.

Gjithashtu propozoi që në takimin që do të realizohet me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë apo me Ministrin e Punëve të Brendshme, duhet të përmenden rastet e tilla.

Kryetari i Komisionit- Për rastin e paraqitur nga z. Marinković, ai tha se kjo çështje është trajtuar edhe në mbledhjen e kaluar, dhe duke qenë se tani posedojmë edhe dokumentacionin, në takimin që do të realizohet me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, mund të shtrohen pyetje për rastet e caktuara, por konsideroi se nuk duhet të tejkalohen institucionet për vënien e një të drejte në vend, prandaj konsideroi si të rëndësishme themelimin e IPK-së, si institucion ku mund të paraqiten ankesat e qytetarëve për zyrtarët policor, ndërsa Komisioni ka funksionin e hartimit dhe ndryshimit të ligjeve, mbikëqyrjes së zbatimit të tyre, prandaj konsideroi se si deputet kemi përgjegjësinë për ti ndihmuar qytetarët për tu drejtuar në institucionet kompetente për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Rexhep Selimi- Për shqetësimin e paraqitur nga z. Marinković, ai tha se kompetenca e Komisionit është në rolin mbikëqyrës të tij dhe jo shqyrtimit të ankesave. Tutje tha se bashkohet me shqetësimin e paraqitur dhe se çdo qytetar duhet të veproj në përputhje me ligjin dhe proceduar që parasheh ai për procedimin e ankesave, dhe se roli i Komisionit do të ishte në mbikëqyrjen e këtij procesi dhe zbatueshmërisë së ligjit, pasi Komisioni nuk ka funksion ekzekutiv por ai ushtron funksion mbikëqyrës.

Goran Marinković- Për propozimet e dhëna nga anëtarët, ai tha se pajtohet me vlerësimin dhe përkrahjen, por sipas tij duhet të jemi real, pasi Komisioni ka kompetencë mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së ligjit. Gjithashtu në takimin me Drejtorin e Policisë, ai tha se do ti shtrohet pyetja se sa mundet një person të veproj mbi ligjin, pasi raste të tilla nuk janë të pakta, prandaj konsideroi se nëse pyesim për zbatueshmërinë e ligjit nuk është jashtë fushës që mbulon Komisioni . Gjithashtu si përfaqësues i komunitetit serb, ai tha se në rastet të tilla e konsideron se ka pasur shkelje të ligjit dhe e sheh të nevojshme që në takimet e radhës të paraqitet si çështje.

Rexhep Selimi- Për çështjen e ngritur nga z. Marinković, ai tha se në rastin e paraqitjes së këtij rasti në takimin me Drejtorin e Policisë dhe me IPK-në, çështje do të shtrohet në kontekstin nëse është paraqitur një rast i tillë në institucionet kompetente, prandaj ai e konsideroi si mangësi në procedurë nëse nuk do të paraqitej pranë institucioneve kompetente.

Goran Marinković- Tha se pajtohet me z. Rexhepi, që do të ketë kundër pyetje, gjithashtu e konsideron si të nevojshme hapjen e një zyre të IPK-së në Graçanicë, në mënyrë që qytetarët serb të mund ti paraqesin ankesat e tyre ndaj Policisë së Kosovës.

Kryetari i Komisionit- Në takimin që do të realizohet me Drejtorin e Policisë, ai tha se do të diskutohet për çështjet e ngritura nga ky takim dhe se anëtarët do të mund të paraqesin raste pasi kjo do ti shërbente mbikëqyrjes së zbatueshmërisë së ligjit.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Ahmet Isufi

Kryetari i Komisionit
